



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	15.07.2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	4138/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.497/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.497/2022 të datës 03.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.497/2022 e datës 03.06.2022 e parashtruar nga ankues.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër DM 344/2022 i datës 31.05.2022 i Zëvendës Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Akt emërimit me numër të reference 35/DL 9 të datës 18.08.2014, në pozitën „Kryesues i Njesisë për Përfaqësim Ligjorë” në Departamentin Ligjor, sipas Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 të nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është transferuar përkohësisht në pozitën „Kryesues i Komisionit të Listave të 20% të Punëtorëve”, Departamenti i Komisioneve Profesionale me gradë/hap 3-6 nga pozita „ Kryesues i Njesisë për Përfaqësim Ligjorë” gradë/hap 3-6, për periudhë gjashtë (6) muaj nga data 16.12.2021 deri me datë 15.06.2022, për interes të institucionit.

Kundër Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 11.01.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë më datë 23.02.2022, mori Vendim me numër A.nr.09/2022, me të cilin e refuzoi si të pa bazuar ankesën e datës 11.01.2022 të parashtruar nga ankuesi

Pas pranimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 23.02.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 31.05.2022 nxjerr Vendimin me numër DM 344/2022 me të cilin vendim plotësohet gjegjësisht përcaktohet periudha e transferit dhe shkaqet e shtyrje së zbatimit të Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër DM 344/2022 të datës 31.05.2022 të nxjerr nga Zëvendësuesi Drejtorit Menaxhues i Agjencionit Kosovar të Privatizimit, me datë 03.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe me numër të protokollit 3235/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.06.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Me datë 16.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 03.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 31.05.2022; Vendimi A.Nr.09/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 15.06.2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 18.08.2014; e-mail i datës 04.03.2022; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit i datës 16.06.2022 si dhe provat shtesë të ankuesit të datës 28.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje thelbësorë të dispozitave të ligjit të procedurës administrative, shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit për zyrtarët publik si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale më tej thekson se për të njëjtën çështje Këshilli ka vendosur me ankesën me numër A.nr.09/2022 të datës 23.02.2022

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe dëshmitë e ofruara konkretisht Vendimin me numër DM 344/2022 të datës 31.05.2022, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa qëndrueshëm pasi që me Vendimin me numër DM 344/2022 të datës 31.05.2022 vetëm është plotësuar Vendimi i datës

16.12.2021 me numër DM 1249/2021 lidhur me afatin e transferit të përkohshëm për ankuesin për shkak se ndaj Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 për transferim të përkohshëm ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj ky vendim nuk është zbatuar nga organi i punësimit deri në marrjen e vendimit përfundimtarë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe pas vendosjes së ankesës së ankuesit nga ana e Këshillit, Zëvendës Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka nxjerr Plotësim-Vendimin DM 344/2022 të datës 31.05.2022 për transferimin e përkohshëm të ankuesit në vendin e punës "Kryesues i Komisionit të Listave të 20%, Komisioni i Listave të 20% të Punëtorëve", Departamenti i Komisioneve Profesionale me gradë/hap të njëjtë 3-6, respektivisht në këtë vendim është përcaktuar saktë se periudha 6 mujore e transferimit llogaritet nga data 07.03.2022 gjer më 07.09.2022, për arsye se ky vendim nuk është zbatuar deri me datën 07.03.2022 ngase ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës dh duke u bazuar ne faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Vendimi me numër DM 344/2022 të datës 31.05.2022 është marrë në interes të institucionit duke vepruar në pajtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është përcaktuar se: "Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve", duke u lidhur me nenin 4 paragrafin 1 paragrafin 4 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit", 4."Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit"....., dhe 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme", andaj ne rastin konkret Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se me Vendimin me numër DM 344/2022 të datës 31.05.2022 vetëm është plotësuar Vendimi i datës 16.12.2021 me numër DM 1249/2021 gjegjësisht është përcaktuar afati i transferit të përkohshëm për ankuesin për shkak se Vendimi me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 për transferim të përkohshëm nuk është zbatuar nga organi i punësimit deri me date 07.03.2022 për shkak se ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj plotësim-vendimi për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga ana e zëvendësuesit Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është bërë pas vlerësimit të gjendjes aktuale të institucionit konkretisht për interes të institucionit pas pensionimit të nëpunësit civil që ka qenë në pozitën të Departamentit të Komisioneve Profesionale, ka vlerësuar se janë krijuar kushtet që ankuesi të transferohet përkohësisht për periudhën gjashtë (6) muaj, në pajtim me dispozitat e lartë cekura dhe rrethanat e krijuara pas pranimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 23.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se zëvendësuesi Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me rastin e nxjerrjes së Plotësim-Vendimit me Nr.DM 344/2022 mbi transferimin e përkohshëm të datës 31.05.2022, ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me të cilin.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.497/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

